



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 634 prot.

Tiranë, më 24 . 04 . 2024

V E N D I M

Nr. 113 , datë 24 . 04 . 2024

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 216 Regj., datë 16.10.2023³, paraqitur nga subjekti ankues I. L, kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH), me pretendimin e diskriminimit për shkak të “bindjeve politike të familjarëve të tij”, “vendbanimit” dhe “gjendjes familjare”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në parashtrimet e dokumentacionin e depozituar nga subjekti ankues, I. L, rezulton se ai është pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit prej 27 vitesh, nga të cilat 23 vite karrierë policore dhe 4 vite arsimim në Akademinë e Sigurisë.

Ankuesi parashtron se: “Jam prind i dy fëmijëve të mitur 8 dhe 4 vjeçar dhe familja ime jeton në Sarandë. Gjithashtu kam edhe detyrime për përkujdesje edhe ndaj dy prindërve të mi, 75 dhe 84 vjeçar.

Prej një viti e gjysmë jam emëruar e transferuar në detyrën e Shefit të Sektorit, në Sektorin Operacional për Përgjimet Ambientale në Drejtorinë Vendore Kukës, largësi jashtëzakonisht e madhe nga vendbanimi i familjes time, në Sarandë. Besoj jam i vetmi rast në strukturën e Policisë së Shtetit me detyrë kaq larg familjes. Largësia e madhe ka sjellë ngarkesë psikologjike tek fëmijët e familja ime, duke ma bërë të papërbalueshme punën në një largësi të tillë”.

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

³ Plotësuar nëpërmjet e-mailit të datës 22.10.2023.

Subjekti ankues ka paraqitur kërkesa të herëpashershme drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të DPPSH-së, si dhe Ministrisë të Brendshme, lidhur me shqyrtimin e mundësisë për transferimin e tij më afër vendbanimit të familjes, duke pretenduar se ndaj tij kishte tendencë e veprime diskriminuese nga struktura përgjegjëse e DPPSH-së për transferimin e tij, pasi ai ishte trajtuar në mënyrë të pabarabartë e të pafavorshme krahasuar me kolegët e tij, të cilët janë transferuar pranë vendbanimeve të familjeve të tyre, pas qëndrimit të tyre në detyrë për vetëm 5 apo 7 muaj.

Ankuesi ka pretenduar se ky trajtim i pafavorshëm e diskriminues nga ana e DPPSH-së, atij i bëhet për shkaqet e pretenduara: bindjet politike të familjarëve të tij, vendbanimit të tij, si dhe gjendjes familjare (si prind me dy fëmijë të vegjël dhe prindër në moshë të thyer, për të cilët duhet të kujdeset).

Në përfundim të ankesës së tij, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e DPPSH-së, për shkaqet e pretenduara prej tij, përmes mosveprimit për marrjen e masave për transferimin e tij në një vend pune në distancë më të afërt me vendbanimin e familjes së tij.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD dhe që lidhen me pretendimin e ankueses për diskriminim.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, u konstatua se ajo kishte mangësi të natyrës formale të saj, dhe për këtë arsye, inspektori i çështjes, nëpërmjet e-mailit datë 18.10.2023, ka kërkuar nga ankuesi ta plotësojë atë si dhe të depozitojë dokumentacion provues apo shpjegime bindëse lidhur me provueshmërinë e shkaqeve të pretenduara prej tij.
 - Në vijim të sa më sipër, ankuesi së nëpërmjet e-mailit datë 23.10.2023, ka plotësuar kërkesat e KMD-së, duke dërguar informacion dhe dokumentacion shtesë.
2. Nëpërmjet shkresës me nr. 1108/1 prot., datë 31.10.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrime subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, DPPSH-së, si dhe dokumentacion provues⁴, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.
 - Nëpërmjet shkresës me nr. 9584/1 prot., datë 14.11.2023, Komisioneri është njohur me qëndrimin institucional të DPPSH-së, përsa i takon pretendimit të ankuesit. Parashtrimet e DPPSH-së janë si më poshtë vijon:

“Ju informojmë se, punonjësi i policisë, I. , është pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit, prej 23 vitesh. Gjatë karrierës së tij ka shërbyer në strukturat e hetimit të krimit në drejtoritë vendore të

-
- ⁴ Kopje të dokumentacionit të dosjes personale të subjektit ankues (emërime, transferime, masa disiplinore, vlerësime performance, nëse ka, etj)
 - Cila është baza ligjore që aplikohet në rastet e transferimeve të punonjësve të Policisë së Shtetit me gradë të njëjtë apo të ngjashme me të ankuesit.
 - Procedura e ndjekur për transferimin e subjektit ankues në DVP Kukës.
 - Informacion dhe parashtrime lidhur me nevojën e paraqitur për të transferuar ankuesin në DVP Kukës.
 - Informacion nëse z. L është ankuar për transferimin apo për diskriminim ndaj tij. Nëse po, kopje të praktikës shkresore të mbajtur mes jush.
 - Informacion nëse ka raste të ngjashme që janë transferuar për nevoja pune, 400 km larg vendbanimit të tyre (apo distanca të përafërta) punonjës të Policisë së Shtetit me gradë të njëjtë apo të ngjashme me ankuesin. Nëse po, të evidentohet secili rast (emri punonjësit të PPSH-së, grada, vendbanimi dhe vendi i punës ku është transferuar).
 - Informacion nëse ka raste të ngjashme të punonjësve të tjerë të PPSH-së, me gjendjen familjare të ankuesit (me fëmijë të mituar apo prindër të moshuar) dhe janë transferuar në një distancë të tillë nga vendbanimi i tyre. Nëse po, të evidentohet secili rast, si më sipër.
 - Informacion lidhur me transferimet e punonjësve: Kryekomisar B. A, Komisar D. V, D. A, A. Rr. Të evidentohen të dhënat si më poshtë:
 - Periudha kur janë transferuar larg vendbanimeve të tyre, vendi ku janë transferuar, datat, si dhe të dhëna për përbërjen, gjendjen familjare të secilit, vendbanimeve respektive.
 - Informacion dhe parashtrime lidhur me pamundësinë e transferimit të subjektit ankues, si dhe lidhur me konsiderimin e transferimit të punonjësve sipërcituar (sipas pretendimit të subjektit ankues).
 - Informacion lidhur me masat e ndërmarra nga ana juaj, nëse ka të tilla, lidhur me konsiderimin e transferimit të ankuesit në një distancë të arsyeshme nga vendbanimi i familjes së tij.

Policisë Fier, Vlorë, Gjirokastrë, me përjashtim të një periudhe të shkurtër prej 8 muajsh, në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë me Vendimin nr. 21-2013-1215/673, datë 12.07.2023, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, i ka dhënë të drejtën për marrjen e gradës policore “Kryekomisar”.

Në Komisariatin e Policisë Sarandë, grada “Kryekomisar” i korrespondon funksionit të Shefit të Komisarariatit dhe duke qenë se ky funksion nuk ka qenë i lirë, ndodhur në kushtet e zbatimit të vendimit të gjykatës, kur i është dhënë grada “Kryekomisar” dhe për plotësim të funksioneve të lira organike dhe nevoja pune, është transferuar e emërtuar në detyrën “Shef Sektori”, në Sektorin e Shërbimeve Policore të Specializuara, në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës, me të drejta administrative dhe financiare në datën 17.02.2022.

Në zbatim të Urdhrit nr. 47, datë 14.04.2023, të Ministrit të Brendshëm “Për miratimin e strukturës dhe të organikës në nivel qendror, vendor dhe strukturat e veçanta të Policisë së Shtetit”, gjatë periudhës Qershor-Korrik 2023, u implementua struktura e re organike.

Me propozimin nr. 1761, datë 26.05.2023, të Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës dhe miratim të Këshillit të Lartë të Vlerësimit të Propozimeve për Emërim, Kryekomisar I. L, është emëruar në detyrën Shef Sektori, në Sektorin Operacional për Përgjimet Ambientale, në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës, detyrë të cilën kryen aktualisht.

Në dinamikën e transferimeve dhe emërimeve në detyrë, në 90% të rasteve punonjësit e policisë transferohen dhe emërohen në detyrë, sipas nevojave të Policisë së Shtetit, në raport me funksionet e lira dhe karrierën e punonjësit.

Në bazë të VKM-së nr. 451, datë 29.06.2022, Kryekomisar L, trajtohet financiarisht me pagesë për kompensim udhëtimi për shkak të transferimit me detyrë jashtë vendbanimit të tij dhe pagesë për bashkëshorten e papunë.”

Bashkëlidhur parashtrimeve, DPPSH, ka dërguar edhe një pjesë të dokumentacionit të kërkuar.

3. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 82 prot., datë 15.01.2024, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore.

Palëve iu është bërë e ditur se mund të depozitojnë paraprakisht ose gjatë seancës parashtrime dhe dokumente, fakte e prova që mbështesin pretendimet e tyre.

Njëherësh, nëpërmjet e-mailit, subjektit ankues i janë bërë të njohura parashtrimet e DPPSH-së.

4. Seanca dëgjimore u zhvillua me datë 24.01.2024, me praninë e subjektit ankues personalisht, dhe përfaqësuesit të DPPSH-së, z. A. Gj, me detyrë Shef i Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, pranë këtij institucioni.

Palët u qëndruan të njëjtave pretendime⁵ si ato të bëra të njohura shkresërisht në ankesën e parashtrimet e depozituara prej tyre pranë KMD-së.

Pala ankuese, ndër të tjera, theksoi qëndrimin e tij lidhur me pretendimin për diskriminim nga ana e DPPSH-së, si më poshtë citohet:

“Duke mos gjetur zgjidhje pas bërjes prezent Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, në mënyrë të përsëritur, të shqetësimeve të mia nëpërmjet kërkesave për të më transferuar në një nga Drejtoritë Vendore apo të Kufirit dhe Migracionit, më pranë vendbanimit të familjes time, duke i bërë të qarta arsyet e mia familjare të krijuara nga largësia e tejskajshme nga familja ime, nga njëri skaj i Shqipërisë tek tjetri, shqetësimeve për sigurinë e familjes time nga armiqësi të krijuara gjatë kryerjes së detyrës në karrierën time 23 vjeçare në Policinë e Shtetit, në përballje me kontigjentin kriminal; arsye këto të bëra prezent pranë DPPSH-së, si në kërkesat për transferim, ashtu edhe në ankimin tim drejtuar DPPSH-së, me datë 20.06.2023, duke parë se edhe pas ankimit tim pranë KMD-së, vazhdoi i njëjti trajtim indiferent ndaj situatave të mia familjare të krijuara nga largësia e tejskajshme nga familja, me keqardhje për mospërfilljen dhe indiferentizmin ndaj meje, të sakrificës të një jete punë në Policinë e Shtetit, me datë 12.01.2024, kam paraqitur dorëheqjen për arsye familjare nga Policia e Shtetit.

Me Urdhrin nr. 135/1 prot., datë 18.01.2024 është miratuar lirimi nga Policia e Shtetit sipas kërkesës time.

Në kërkesë kam parashtruar se dorëheqja ime ka ardhur si rezultat i mosgjetjes së zgjidhjes për arsyet e mia familjare të krijuara nga mosdhënia e mundësisë për të më transferuar me detyrë në një nga drejtoritë më pranë vendbanimit të familjes time dhe shqetësimit për sigurinë e familjes për shkak të largësisë së tejskajshme.

Arsyet që më çuan në këtë vendim janë lënia në detyrë për një kohë të gjatë dy vjeçare në këtë largësi nga familja dhe dy fëmijët e mitur, ndërkohë që kolegët në kushte edhe më të favorshme se unë transferoheshin pa asnjë pretendim.

Kryekomisar F. A/ Shef Sektori i Trafikut Rrugor në DVP Kukës, është transferuar vetëm 4 apo 5 muaj pasi kishte marrë detyrën, duke i shkurtuar largësinë nga vendbanimi i tij dhe Komisar A. M/ Shef i Seksionit Operacional, në Sektorin ku unë mbuloja, u emërua në muajin korrik në DVP Kukës dhe në muajin dhjetor u transferua përsëri pranë familjes në Tiranë.

Me vendimin nr. 1708, datë 16.11.2023 të DPPSH-së janë shpallur 200 (dyqind) vende të lira për gradën Kryekomisar, dhe nuk u konsiderua mundësia për të më sistemuar në një vend pune, të paktën

⁵ Depozituar shkresërisht gjatë seancës.

duke më përgjysmuar largësinë nga vendbanimi im, duke më demoralizuar deri në atë pikë sa më detyruan të largohem nga Policia e Shtetit.

Unë me këtë punë kam jetuar dhe rris fëmijët dhe kam nevojë për rrogën. E kam patur pasion dhe e dua punën në Policinë e Shtetit, por nuk mund t'u krijoj trauma fëmijëve me mungesën time me ditë të tëra në familje, si dhe të rrija me frikën se mos ndonjë nga kontigjentët kriminalë, anëtarë të bandave kriminale që kam hetuar e arrestuar, u lind dëshira për t'u hakmarrë ndaj familjes time dhe unë e kam të pamundur të reagoj sepse jam qindra kilometra larg.

Jam denigruar deri në atë pikë nga injorimi i kërkesave të mia për transferim sa u detyrova të lija punën edhe pse jam një oficer dinjitoz karriere i Policisë së Shtetit, gjë që e kam treguar me punën time duke ruajtur si dinjitetin e punonjësit të Policisë, ashtu edhe atë personal.”

Z. A Gj, Shef i Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, pranë DPPSH-së, ndër të tjera, theksoi se: “ Në lidhje me informacionin e punonjësve të cituar nga ankuesi: B. A, D. V, D. A dhe A. R, ju informoj si më poshtë vijon:

- Kryekomisar B. A, i datëlindjes 1972, banues në Gjirokastrë i është dhënë grada Kryekomisar si dhe është transferuar nga DVP Gjirokastrë në DV Kukës me Urdhrin nr. 1843, datë 15.08.2022 të DPPSH-së. Përbërja familjare prej tre personash (B, bashkëshortja dhe një fëmijë). Me datën 16.03.2023, me Urdhrin nr. 542, datë 13.03.2023 është transferuar pranë DV Berat.

- Nënkomisar A. R, i datëlindjes 1972, banues në Tiranë është transferuar nga Akademia e Sigurisë në DVKM Kukës, me detyrë Përgjegjës Turni në Stacionin e Policisë Kufitare Morinë. Gjendja familjare, i ve, me një fëmijë të mitur. Aktualisht banon në Tiranë. Me Urdhrin nr. 3463/1, datë 20.07.2023 është transferuar pranë Akademisë së Sigurisë Tiranë.

- Nënkomisare D. A, e datëlindjes 1989, banuese në Tiranë është transferuar nga DVP Tiranë në DVP Kukës, me Urdhrin nr. 1420/1, datë 20.06.2022, pas përfundimit të ciklit të parë të studimeve në Akademinë e Sigurisë. Me Urdhrin nr. 1420/2, datë 31.10.2022 është transferuar pranë DVP Tiranë, pasi kjo punonjëse ka aplikuar pranë DVP Tiranë për vazhdimin e studimeve dhe për mungesë të funksioneve organike për gradën Nënkomisar në momentin e përfundimit të shkollës, është transferuar në DVP Kukës.

- Nënkomisar D. V, i datëlindjes 1973, banues në Vlorë është transferuar nga DVKM Vlorë, në DVP Kukës me Urdhrin nr. 1792, datë 03.08.2022. Me Urdhrin nr. 882, datë 24.04.2023 është transferuar pranë DVP Vlorë. Është i martuar me dy fëmijë.

Dinamika e punës në DPPSH është e tillë që gjithmonë do të ketë transferime të punonjësve të saj për nevoja pune, por në asnjë rast DPPSH nuk ka diskriminuar ankuesit apo punonjësit e saj, për asnjë shkak.”

Në përfundim të seancës, palëve iu komunikua se, në rast të dakordësisë mes tyre për një zgjidhje miqësore të çështjes⁶, duhet që brenda një afati 3 (tre) javor t'ia komunikonin KMD-së këtë fakt. Në të kundërt, mund të paraqesin çdo provë, dokumentacion a qëndrim të tyre, lidhur me sa pretendohet, të cilat do të depozitohen në dosjen e ankuesit dhe do të shqyrtohen e analizohen bashkërisht e në harmoni me të gjitha aktet e tjera të dosjes.

5. Në kushtet kur palët nuk janë dakordësuar për një zgjidhje miqësore të pretendimeve të ankuesit, në vijim të detyrave të lëna gjatë seancës dëgjimore, me shkresën me nr. 1485/1 prot., datë 12.02.2024, DPPSH, depozitoi informacion shtesë, duke cituar, ndër të tjera, se:

“...sipas ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, punonjësit e Policisë transferohen në strukturat policore në raport me gradën, fushën e shërbimit ku janë profilizuar. Për shkak se strukturat e Policisë së Shtetit kanë një shtrirje në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, punonjësit e Policisë, për nevoja të Policisë së Shtetit transferohen në të gjitha strukturat policore.

Vetë ligji ka parashikuar edhe përfitime që merr punonjësi i policisë në rastet e transferimeve si: kompensim financiar për bashkëshorten/in kur humbet punën për shkak të transferimit, përfitim për largësinë jashtë vendbanimit të tyre apo pagimin e qirasë së banesës. Ligjvënësi i ka përcaktuar këto benefite, duke marrë parasysh se punonjësit e Policisë e kanë të pamundur të punojnë gjatë gjithë kohës brenda vendbanimit të tyre, me përjashtim të rasteve kur ata janë në nivel zbatues, ku edhe 80% e funksioneve organike i përkasin këtij niveli e për pasojë mundësitë e sistemimit të punonjësve brenda vendbanimit janë më të mëdha.

Transferimi i z. L, është bërë për shkak të gradës policore që i është dhënë me vendim gjykate, gradë e cila është e nivelit menaxherial. Pavarësisht kësaj, z. L ka përfituar transfertën e bashkëshortes, përfitim i cili merret në rastet kur punonjësi i policisë tërheq familjen në bashkinë ku është transferuar dhe logjikisht pretendimi i tij se punon larg familjes nuk mund të qëndrojë për aq kohë sa ka përfituar trajtim financiar për bashkëshorten.

Në lidhje me transferimet e punonjësve të tjerë, përveç atyre që citoi gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i DPPSH-së, ju informojmë se:

- *Kryekomisar F. A, i datëlindjes 1975, banues në Tiranë, është transferuar nga Akademia e Sigurisë në DVP Kukës, me Urdhrin me nr. 3650, datë 07.07.2022. Me Urdhrin e datës 22.11.2023 është transferuar për nevoja pune pranë DVP Shkodër, dhe është i martuar, me dy fëmijë.*

Ndërkohë, pavarësisht referimeve të emrave të mësipërm apo edhe emrave të punonjësve të tjerë të cilët janë transferuar para z. L, nga verifikimet e kryera rezulton se ka punonjës policie të shumtë që kanë qëndruar larg vendbanimit të tyre, më tepër se z. L, e konkretisht citojmë si më poshtë vijon:

- *Komisar Xh. K, i datëlindjes 1962, banues në Laç/Kurbin, është transferuar nga DVP Lezhë, me Urdhrin nr. 565/1, datë 2017 në DVP Korçë. Ka qëndruar në DVP Korçë, afërsisht 4 vite, larg vendbanimit të tij, në një largësi mbi 250 km. Me Urdhrin nr. 279/1, datë 24.02.2021*

⁶ Pika 9, e nenit 33, të LMD-së parashkon se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa.”

është transferuar pranë DVKM Kukës. Është i martuar dhe me dy fëmijë. Prej vitit 2021 vazhdon të jetë me punë në DVKM Kukës.

- Komisar B. Q, i datëlindjes 1973, banues në Pogradec, është transferuar nga DVP Korçë, me Urdhrin nr. 713/1, datë 12.05.2021 në DVKM Kukës dhe është i martuar, me dy fëmijë.
- Nënkomisar A. E, i datëlindjes 1966, banues në Tiranë, është transferuar nga DVP Tiranë me Urdhrin nr. 1581/1, datë 16.11.2020 në DVP Lezhë, deri me datë 03.02.2022. Me Urdhrin nr. 271/1, datë 14.06.2022 është transferuar pranë DVKM Kukës, dhe është i martuar, me një fëmijë.
- Komisar A. B, i datëlindjes 1977, banues në Elbasan, është transferuar nga DVP Korçë, me Urdhrin nr. 100/2, datë 06.12.2021 në DVP Dibër, është i martuar dhe me fëmijë.
- Nënkomisar Y. A, i datëlindjes 1975, banues në Tiranë, është transferuar nga Njësia Speciale Operacionale për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, me Urdhrin nr. 973, datë 29.03.2013 në DVKM Kukës, deri në mars 2021. Me Urdhrin nr. 402, datë 04.03.2021, është transferuar pranë DVKM Korçë.

Rastet e mësipërme i referuam pranë jush, jo për të justifikuar mos transferimin e z. L, por për të argumentuar se transferimi larg vendbanimit të tyre i punonjësve të Policisë së Shtetit, është prezent në Policinë e Shtetit dhe do të jetë edhe në të ardhmen, pasi është i pamundur punësimi i punonjësve brenda vendbanimit të tyre për shkak se veprimtaria e Policisë së Shtetit shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke ritheksuar se për këtë shkak vetëm punonjësit e policisë trajtohen me kompensim për shkak të largësisë, pagesë të bashkëshortes apo pagesë të qirasë së banesës, ndërkohë që këtë trajtim nuk e përfitojnë punonjës të tjerë të Administratës Publike.

Lidhur me kërkesën e KMD-së për të evidentuar të gjithë vendet e lira, në Drejtoritë Vendore, ju informojmë se:

Për muajin gusht 2023:

- Shef i Sektorit të Menaxhimit dhe Drejtimit, ne DVP Tiranë.
- Shef i Sektorit të Inteligjencës dhe Arkivës Kriminale, DVP Durrës.
- Shef i Sektorit për Hetimin e Narkotikëve, DVP Shkodër.
- Shef i Sektorit të Inteligjencës dhe Arkivës Kriminale dhe Shef i Sektorit për Krimet në Volum, në DVP Elbasan.
- Shef i Sektorit të Policisë Shkencore, DVP Fier.
- Shef i Sektorit të Inteligjencës dhe Arkivës Kriminale, Shef i Sektorit për Hetimin e Krimeve të Rënda, Shef i Sektorit për Krimet në Volum dhe Shef i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, DVP Korçë.
- Shef i Sektorit Operacional për Përgjimet Ambientale, në DVP Dibër.

Për muajin dhjetor 2023:

- Shef i Sektorit të Menaxhimit dhe Drejtimit, ne DVP Tiranë.
- Shef i Sektorit të Inteligjencës dhe Arkivës Kriminale, DVP Durrës.
- Shef i Sektorit të Inteligjencës dhe Arkivës Kriminale, DVP Elbasan.
- Shef i Sektorit të Policisë Shkencore, DVP Fier.

- *Shef i Sektorit të Inteligjencës dhe Arkivës Kriminale dhe Shef i Sektorit për Hetimin e Krimeve të Rënda, në DVP Korçë.*
- *Shef i Sektorit Operacional për Përgjimet Ambientale, në DVP Dibër.*
- *Shef i Sektorit të Kufirit, në DVKM Korçë.”*

6. Në vijim të seancës dëgjimore, subjekti ankues nëpërmjet e-mailit datë 12.02.2024, ka depozituar pranë KMD-së, informacion shtesë, si dhe ka depozituar dokumentacion i cili i është bashkëlidhur akteve të tjera të dosjes së tij. Në parashtrimet e tij, ankuesi citon se:

“Përsa i përket mundësisë së lënë nga ana juaj për një zgjidhje me pajtim midis palëve, unë e dhashë dakordësinë time, por ky fakt nuk u mor parasysht nga ana e DPPSH-së, për krijimin e mundësisë për gjetjen e një pozicioni pune në një largësi të arsyeshme nga familja ime, qoftë edhe sa gjysma apo pak më shumë e largësisë nga Saranda në Kukës.

Në ankimin tim kam sqaruar se diskriminimi im është në raport me familjen time, bashkëshorten dhe dy fëmijët e mitur, përkatësisht 8 dhe 4 vjeçar, si dhe detyrimet kundrejt dy prindërve të moshuar.

Përsa i përket prindërve, unë jam fëmija i vogël dhe prindërit janë mbështetur tek unë si djali i pleqërisë. Prindërit prej vitesh janë banorë të Sarandës, por nuk janë me mua në certifikatën familjare. Prindërit bëjnë një jetë të ndërthurur midis Sarandës dhe Mallakastrës. Gjatë muajve që prindërit janë në Sarandë, për çdo gjë që kanë nevojë janë detyrime të miat familjare, por padiskutim që edhe vëllezërit e mi të cilët jetojnë në qytetin e Fierit, kanë detyrimet e tyre ndaj prindërve.

Përsa i përket diskriminimit tim...megjithëse kishte mbi 200 vende të lira për Kryekomisar, u emërova me detyrë 400 km larg familjes time. I vetmi rast besoj në të gjithë DPPSH, duke më lënë në këtë detyrë për gati dy vjet edhe pse i kam bërë të qarta arsyet e mija familjare.

Nëse do isha me punë 100 km, 150 km apo 200 km, nuk do t'i drejtohesha fare DPPSH-së për transferim pranë familjes time, pasi do gjykoja se kjo është puna, ky është profesioni im të cilin kam marrë përsipër ta kryej edhe nëse një ditë do të vinin pasoja për jetën time në përballje me krimin, etj. Por, askush nuk ka të drejtë të luajë me sigurinë e familjes time, e të më lërë në punë 400 km larg tyre, me dy fëmijë të mitur në pamundësi praktike për t'i takuar. Ata e kishin të qartë se nëse unë nuk do të përfillesha për të më zgjidhur këtë problematikë dukë më afruar vendin e punës me vendbanimin, do të detyroheshja të lija punën duke u dorëhequr. Nuk ishte çështje malli nga largësia por çështje sigurie e familjes time, nisur nga natyra e punës që kam patur e kryer. Çështja e mallit nga largësia vjen e fundit në radhën e detyrimeve të mia si prind ndaj familjes.”

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të

njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 12/1/c, ku përcaktohet se:

“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ... c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të subjektit ankues, (depozituara në ankesën me nr. 216 regj., datë 16.10.2023, pranë KMD-së) Komisioneri vlerëson se objekt i gjykimit e analizës të kësaj vendimmarrje, janë ato pretendime mbi bazën e të cilave janë investuar palët gjatë shqyrtimit të ankesës, dhe për e mbi të cilat ka vijuar procedura hetimore, kundrejt subjektit për të cilin ka pretenduar se e ka diskriminuar, DPPSH-së: lidhur me mosmiratimin e kërkesës së tij për transferim në një qytet më afër vendbanimit të tij.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me punonjës të tjerë në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”. Mirëpo, në kushtet kur ky “krahasues” mungon, vlerësohet nëse ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë në raport me parashikimet ligjore që normojnë marrëdhënien mes tij dhe punëdhënësit.

Bazuar në analizimin e fakteve, dokumentacionit të depozituar e kronologjinë e ngjarjeve, rezultonte se:

Subjekti ankues I. L, ishte pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit, prej 23 vitesh. Referuar dokumentacionit të depozituar, evidentohet se historiku i gradave të ankuesit është si më poshtë vijon:

- Nga data 06.09.2000 deri me datë 30.04.2003, ka mbajtur gradën N/toger;
- Nga data 01.05.2003, deri me datë 15.09.2006, ka mbajtur gradën Inspektor;
- Nga data 16.09.2006, deri me datë 10.06.2008, ka mbajtur gradën N/Inspektor;
- Nga data 11.06.2008, deri me datë 10.02.2022, ka mbajtur gradën Nënkomisar;
- Nga data 17.02.2022, ka mbajtur gradën Kryekomisar, gradë e cila i është dhënë me vendim gjyqësor. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë me Vendimin nr. 21-2013-1215/673, datë 12.07.2023, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë, i ka dhënë të drejtën për marrjen e gradës policore “Kryekomisar”.

Lidhur me pozicionet dhe emërimet e tij në detyrë, nga viti 1997, deri ma datë 01.07.2023, paraqitet situata si më poshtë:

Pozicioni/Vendi i Punës	Nga data:	Deri më datë:
Polic trupë shërbimi, Komisariati i Policisë Mallakastër	01.07.1997	01.11.1997
Inspektor i Policisë Kriminale, Komisariati i Policisë Sarandë	06.09.2000	12.03.2001
Oficer i Policisë Gjyqësore, Komisariati i Policisë Sarandë	13.03.2001	30.09.2004
Oficer i Policisë Gjyqësore, Komisariati i Policisë Sarandë	01.10.2004	30.11.2006
Oficer i Policisë Gjyqësore, Komisariati i Policisë Sarandë	01.12.2006	07.06.2009
Specialist/ Seksioni kundër Krimeve ndaj Pronës, DPQ Vlorë	16.06.2009	30.06.2010
Specialist për Hetimin e Krimeve, Komisariati i Policisë Vlorë	01.07.2010	11.10.2010
Specialist për Hetimin e Krimeve të Rënda, Komisariati i Policisë Sarandë	12.10.2010	07.06.2011
Specialist për Hetimin e Krimeve, Komisariati i Policisë Delvinë	08.06.2011	25.04.2012
Specialist për Hetimin e Krimeve, Komisariati i Policisë Bulqizë	26.04.2012	25.07.2012
Specialist për Hetimin e Krimeve, Komisariati i Policisë Mat	26.07.2012	04.12.2012
Specialist për Hetimin e Krimeve, Komisariati i Policisë Tepelenë	05.12.2012	16.06.2013
Specialist për Hetimin e Krimeve, Komisariati i Policisë Tepelenë	17.05.2013	20.08.2013
Specialist për Hetimin e Krimeve, Komisariati i Policisë Tepelenë	29.08.2013	07.11.2013
Specialist për Hetimin e Krimeve, Komisariati i Policisë Tepelenë	08.11.2013	20.11.2013
Specialist për Hetimin e Krimeve, Komisariati i Policisë Përmet	21.11.2013	12.03.2014
Specialist, Seksioni për Trafikun e Paligjshëm, DPQ Gjirokastrë	13.03.2014	04.11.2015

Specialist për Krimet, Komisariati i Policisë Gjirokastër	05.11.2015	19.02.2016
Specialist për Krimet, Komisariati i Policisë Gjirokastër	20.02.2016	19.06.2016
Specialist për Krimet, Stacioni i Policisë Dropull, DVP Gjirokastër	20.06.2016	10.07.2016
Specialist, Seksioni për Trafikun e Paligjshëm, DVP Gjirokastër	11.07.2016	31.05.2017
Specialist, Seksioni për Trafikun e Paligjshëm, DVP Gjirokastër	01.06.2017	05.10.2017
Specialist për Krimet e Rënda, Komisariati i Policisë Sarandë	06.10.2017	18.06.2018
Shef Poste Policie, Posta e Policisë Livadhja	19.06.2018	30.04.2019
Specialist për KOKR, Komisariati i Policisë Sarandë	01.05.2019	04.03.2020
Specialist për Hetimin e Krimeve, Komisariati i Policisë Sarandë	05.03.2020	16.02.2022
Shef Sektori, Sektori i Shërbimeve Policore të Specializuara, DVP Kukës	17.02.2022	30.06.2023
Shef Sektori, Sektori Operacional për Përgjimet Ambientale, DVP Kukës	01.07.2023	

Lidhur me emërimin e ankuesit në detyrën “Shef Sektori”, në Sektorin e Shërbimeve Policore të Specializuara, në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës, bazuar në përgjigjen e DPPSH-së, rezulton se, në Komisaratin e Policisë Sarandë, grada “Kryekomisar” i korrespondon funksionit të Shefit të Komisarariatit dhe duke qenë se ky funksion nuk ka qenë i lirë, ndodhur në kushtet e zbatimit të vendimit të gjykatës, kur i është dhënë grada “Kryekomisar” dhe për plotësim të funksioneve të lira organike dhe nevoja pune, është transferuar e emërtuar në detyrën “Shef Sektori”, në Sektorin e Shërbimeve Policore të Specializuara, në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës, me të drejta administrative dhe financiare në datën 17.02.2022.

Në zbatim të Urdhrit nr. 47, datë 14.04.2023, të Ministrit të Brendshëm “Për miratimin e strukturës dhe të organikës në nivel qendror, vendor dhe strukturat e veçanta të Policisë së Shtetit”, gjatë periudhës Qershor-Korrik 2023, u implementua struktura e re organike. Me propozimin nr. 1761, datë 26.05.2023, të Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës dhe miratim të Këshillit të Lartë të Vlerësimit të Propozimeve për Emërim, Kryekomisar I. L, është emëruar në detyrën “Shef Sektori”, në Sektorin Operacional për Përgjimet Ambientale, në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës.

Siç rezulton nga aktet e mësipërme, në rend kronologjik kohor, ankuesi është transferuar për efekt të ushtrimit të detyrës dhe gradës “Kryekomisar”, nga Komisarati i Policisë Sarandë, në DVP Kukës, në detyrën Shef Sektori, Sektori i Shërbimeve Policore të Specializuara, detyrë të cilën e ka marrë me datë 17.02.2022 dhe e ka ushtruar deri me datë 30.06.2023.

Nga data 01.07.2023, deri në datën 18.01.2024, kur është liruar nga Policia e Shtetit, me kërkesën e tij, ka ushtruar detyrën si Shef Sektori, Sektori Operacional për Përgjimet Ambientale, DVP Kukës.

Evidentohet se në vijimësi subjekti ankues ka kërkuar pranë DPPSH-së, të transferohet nga DVP Kukës në strukturat e policisë më afër vendbanimit të familjes së tij, në Sarandë, duke renditur në mënyrë kronologjike si më poshtë vijon:

- Kërkesën me nr. I-41 prot., datë 21.10.2022.

➤ Me shkresën me nr. 87/2-I prot., datë 16.11.2022, DPPSH, sqaron ankuesin se:

“Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, ka marrë në shqyrtim kërkesën tuaj, duke ja kaluar për vlerësim Këshillit të Lartë të Vlerësimit të Propozimeve për Emërim.

Ky Këshill, në mbledhjen e datës 07.11.2022, shqyrtoi kërkesën tuaj dhe konstaton se ka pengesa ligjore për transferimin tuaj, për arsye se nuk plotësoni kriterin e përcaktuar në pikën 5, të nenit 43, të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, ku parashikohet: “Punonjësi i Policisë nuk transferohet nëse nuk ka plotësuar afatin minimal prej 2 vjetësh të qëndrimit në detyrë...”

- Nëpërmjet kërkesës me nr. I-17, datë 25.05.2023, ankuesi i është drejtuar DPPSH-së, me anë të së cilës ka kërkuar të transferohet me detyrë nga DVP Kukës, për në strukturat e tjera të Policisë, më afër vendbanimit të familjes së tij, duke cituar ndër të tjera, si vijon:

“Prej muajit shkurt 2022 jam emëruar dhe transferuar në detyrën e Shefit të Sektorit për Shërbimet e Posaçme Policore në DVP Kukës.

Jam prind i dy fëmijëve të mitur, përkatësisht 7 dhe 3 vjeçar. Familjarisht jetoj në Sarandë. Largësia e punës time nga familja është jashtëzakonisht e madhe dhe nuk u përgjigjem dot fëmijëve dhe familjes për të përmbushur detyrimet e mia familjare si prind, kur ata kanë nevojë për mua si baba. Gjithashtu kam dhe detyrime të tjera familjare ndaj dy prindërve të mi përkatësisht 84 dhe 75 vjeçar.

Për shkak të largësisë jam i detyruar të qëndroj me ditë të tëra në Kukës, edhe kur fëmijët kanë qenë të sëmurë dhe ka qenë e domosdoshme prania ime si baba për t’iu përgjigjur. Mundësinë për transferimin e familjes në Kukës e kam të pamundur.

Si prind, ju vë në dijeni se largësia nga familja prej më shumë se 1 (një) vit e 4 (katër) muaj, ka sjellë ngarkesë të madhe psikologjike tek fëmijët dhe familja për mungesën time si baba në shtëpi, duke më ngarkuar me gjendej stresi edhe mua si prind. Po më bëhet e papërballueshme puna në largësi kaq të madhe nga familja. Ju lutem, si prind, shikojeni të arsyeshme të më transferoni me punë në një nga qarqet më pranë familjes, si në DVP, ashtu dhe në DVKM, ku ta shihni të arsyeshme.”

- Në përgjigje të kërkesës së z. L, me shkresën me nr. 589/1 prot., datë 06.06.2023, DPPSH, ka informuar ankuesin se: *“Kërkesa juaj për transferim nuk mund të zgjidhet pozitivisht, pasi aktualisht strukturat e Policisë së Shtetit janë në proces ristrukturimi.”*
- Nëpërmjet kërkesës me nr. I-17/2, datë 14.07.2023, ankuesi i është drejtuar DPPSH-së, me anë të së cilës ka kërkuar të transferohet me detyrë nga DVP Kukës, për në strukturat e tjera të Policisë, më afër vendbanimit të tij, si DVP Vlorë apo Gjirokastrë.
- Në përgjigje të kërkesës së ankuesit, me shkresën me nr. I/1213 prot., datë 07.08.2023, DPPSH, ka informuar z. L, se: *“Pas shqyrtimit të kërkesës tuaj nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, ju bëjmë me dije se, pavarësisht sa më sipër, ju duhet ta adresoni kërkesën tuaj pranë Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Vlorë, ose DVP Gjirokastrë, e cila ka kompetencë trajtimin e kërkesës tuaj.”*

Pas disa kërkesave të herëpashershme për transferim të tij në një vend pune më afër vendbanimit të tij, ankuesi duke mos gjetur zgjidhje të problematikës së ngritur, me datë 20.06.2023 i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke paraqitur ankimin e tij.

Në vijim, ankuesi, duke mos marrë përgjigje lidhur me ankesën e mësipërme të tij, më datë 15.08.2023, i është drejtuar shkresërisht Ministrit të Brendshëm.

- Me shkresën me nr. I-30/1 prot., datë 18.09.2023, nga Drejtorja e Kabinetit/Ministria e Brendshme, ankuesit i është kthyer përgjigja e mëposhtme:

“Ankesa juaj drejtuar MB-së, në lidhje me transferimin tuaj nga Kukësi në vendbanimin tuaj në Sarandë, është administruar nga ana jonë dhe pas ballafaqimit të parashtrimeve tuaja në të, me aktet normative që rregullojnë këtë proces, rezulton se:

Transferimi i punonjësve të Policisë së Shtetit me gradën “Nënkomisar” deri në “Drejtues të parë”, sipas përcaktimeve të nenit 43, pika 4, të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Sipas dokumentacionit shoqërues të kërkesës tuaj, ju keni kërkuar disa herë në DPPSH, transferimin në Sarandë dhe ata në mënyrë korrekte ju kanë kthyer përgjigje për pamundësinë e realizimit të kërkesës tuaj, deri tani.”

- Në vijim të shkresës së mësipërme, ankuesi me datë 22.09.2023, i është drejtuar sërish, Drejtores së Kabinetit, pranë MB-së, duke saktësuar disa pika të ankimit të tij për diskriminim, si dhe duke kërkuar që ankesa e tij të paraqitet e parashtrohet para Ministrit të Brendshëm për trajtim, duke besuar se ai është autoriteti i duhur që do të gjente dhe zgjidhjen e duhur për të mundësuar transferimin e tij nga Kukësi në një vend pune më afër vendbanimit të tij, qoftë edhe duke përgjysmuar distancën aktuale nga Kukësi-Sarandë.
- Duke mos marrë përgjigje për një zgjidhje pozitive të problematikës së ngritur prej tij, ankuesi me datë 12.01.2024, nëpërmjet një kërkesë, i është drejtuar Drejtorit të DVP Kukës, ku ndër të tjera, citon se, i detyruar nga mosmarrja parasyshe e rrethanave të tij familjare e personale, lidhur me kërkesat e tij të përsëritura lidhur me transferimin e tij në detyrë në një drejtori më pranë familjes së tij, pavarësisht keqardhjes së madhe kërkon të lirohet nga Policia e Shtetit, për arsye familjare dhe personale, cituar në kërkesat e tij të herëpashershme drejtuar DPPSH-së.
- Me Urdhrin nr. 135/1, datë 18.01.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për lirimin nga Policia e Shtetit të një punonjësi policie”, është urdhëruar që: *“Kryekomisar I. L, me detyrë Shef Sektori në Sektorin Operacional për Përgjimet Ambientale, në Sektorin e Përgjimeve Ambientale, në DVP Kukës, të lirohet nga Policia e Shtetit me motivacionin “Kërkon vetë të lirohet”.”*

Bazuar në sa më sipër, evidentohet se subjekti ankues, me datë 17.02.2022, ka filluar ushtrimin e detyrës së tij në DVP Kukës. Pas 8 (tetë) muajsh të qëndrimit në detyrë, në DVP Kukës, me datë 21.10.2022, ankuesi ka depozituar kërkesën e parë për transferim, në një drejtori më afër vendbanimit

të familjes së tij, qoftë edhe duke i përgjysmuar nga Kukësi në Sarandë, kërkesë e përsëritur kjo në vijimësi.

Kuadri ligjor që rregullon transferimin e punonjësit të Policisë së Shtetit.

Në nenin 1, të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj përcakton misionin, organizimin, funksionimin, detyrat, të drejtat dhe statusin e Policisë së Shtetit në Republikën e Shqipërisë, si dhe rregullon veprimtarinë, marrëdhëniet e punës, garantimin e karrierës, mirëqenies dhe vazhdimësisë në detyrë të punonjësit të policisë.”

Neni 12⁷, i këtij Ligji, përcakton se:

“1. Shefi i komisariatit të policisë emërohet nga Drejtori i Policisë së Shtetit, në përputhjet me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në Rregulloren e Policisë.

2. Shefi i komisariatit të policisë është drejtues i nivelit operacional në territorin që mbulon dhe përgjigjet para drejtorit të policisë vendore për rendin e sigurinë publike në juridiksionin e komisariatit të policisë.

3. Shefi i komisariatit të policisë:

a) drejton veprimtarinë e strukturave;

b) menaxhon burimet njerëzore;

c) menaxhon buxhetin;

ç) nxjerr akte të përcaktuara në Rregulloren e Policisë.

d) bashkëpunon me drejtuesit e strukturave vendore brenda juridiksionit dhe fushës përkatëse të kompetencës, me qëllim përmirësimin e policimit dhe sigurinë e komunitetit.”

Neni 43⁸, i këtij Ligji, përcakton se:

“1. Punonjësi i policisë transferohet nga një detyrë në një tjetër brenda së njëjtës gradë që mban, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Policisë.

2. Punonjësi i policisë gjatë periudhës së provës nuk transferohet.

3. Drejtorët e drejtorive vendore të policisë apo titullarët e strukturave të veçanta transferojnë punonjës policie me gradën “Inspektor” në funksione, të cilat janë brenda juridiksionit të tyre, me kusht që funksioni të mos ketë gradë më të ulët se ajo që mban punonjësi.

4. Transferimi i punonjësit të policisë me gradën “Nënkomisar” deri në “Drejtues i parë”, si dhe të gjitha transferimet e punonjësve nga një strukturë në një strukturë tjetër, pavarësisht nga grada, bëhen me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit.

5. Punonjësi i policisë nuk transferohet nëse nuk ka plotësuar afatin minimal prej 2 vjetësh të qëndrimit në detyrë, me përjashtim të rasteve të veçanta, të miratuara nga Drejtori i Policisë së Shtetit.

6. Në çdo rast, transferimi i punonjësit të Policisë së Shtetit bëhet me vendim të motivuar dhe i komunikohet personit të transferuar.

7. Rregullat dhe procedurat e transferimit përcaktohen në Rregulloren e Policisë.”

⁷ Shefi i komisariatit

⁸ Transferimi i punonjësit të policisë

Neni 50/1/b, i këtij Ligji, “Hierarkia e menaxhimit policor”, parashikon se:

“Gradat në polici ndahen në role, sipas kompetencës së veprimit dhe nivelit të menaxhimit, si më poshtë:

.....

b) në rolin e parë drejtues, përfshihen punonjësit e policisë që mbajnë gradën “Nënkomisar”, “Komisar” dhe “Kryekomisar”, që përfaqësojnë nivelin taktik të drejtimit dhe veprimin teknik operacional.”

Qëllimi i Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2015, të ndryshuar⁹, është: *“Përcaktimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e marrëdhënieve brenda dhe jashtë strukturave të Policisë së Shtetit; i parimeve, standardeve dhe normave që rregullojnë sjelljen profesionale dhe etike të punonjësit të Policisë, gjatë dhe jashtë shërbimit; i ecurisë në karrierë dhe menaxhimit të burimeve njerëzore; i vlerësimit të performancës së strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe rregullave për disiplinën dhe procedurave që ndiqen në rastin e shkeljeve disiplinore.”*

Neni 179, i Rregullores së Policisë, përcakton rregullat e përgjithshme për transferimin e punonjësit të Policisë, si më poshtë vijon:

“1. Punonjësi i Policisë mund të transferohet dhe të caktohet në detyrë, kudo qoftë brenda territorit të vendit, sipas rregullave të përcaktuara në këtë rregullore.

2. Si rregull, transferimi i punonjësit të Policisë bëhet brenda së njëjtës gradë dhe fushe shërbimi, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në këtë rregullore.

3. Punonjësi i Policisë nuk transferohet gjatë periudhës së provës.

4. Punonjësi i Policisë nuk transferohet nëse nuk ka plotësuar afatin minimal prej 2 (dy) vjetësh të qëndrimit në detyrë, me përjashtim të rasteve të veçanta të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, për:

a) fitimin e gradës;

b) shkurtim të funksionit organik;

c) arsye shëndetësore dhe familjare;

ç) ekziston një situatë reale dhe e rrezikshme ndaj jetës dhe familjes së punonjësit të Policisë;

d) ndryshim të statusit të funksionit;

dh) kur punonjësi i Policisë nuk arrin nivelin e nevojshëm të kryerjes së detyrave, në funksionin që mban.

5. Në rastet e përcaktuara në pikën 4, t këtij neni, transferimi bëhet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, pavarësisht gradës që mban punonjësi.

6. Punonjësi i Policisë i pranuar në funksione të veçanta, nuk ka të drejtë të transferohet në funksione të tjera policore, për një periudhë 6 (gjashtë) vjeçare.

⁹ Lidhjet bashkëlidhur VKM nr. 750, datë 16.9.2015 mund t'i gjeni në faqen <https://qbz.gov.al> në linkun: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2015/09/16/750/9f07363c-5f1d-484c-8bb7-0168b2a5141e;q=750>

7. Punonjësi i Policisë mund të transferohet përkohësisht nga një detyrë në një tjetër. Kohëzgjatja e transferimit të përkohshëm nuk mund të jetë më shumë se 6 (gjashtë) muaj, brenda 2 (dy) viteve të fundit.

8. Në çdo rast, transferimi i punonjësit të Policisë, bëhet me urdhër të motivuar, me vlerësim të rezultateve individuale të punës dhe i komunikohet personit të transferuar.

9. Transferimi i punonjësit bëhet për të përmirësuar treguesit e punës në strukturat e Policisë së Shtetit, duke vlerësuar edhe të drejtat dhe interesat e punonjësit të Policisë.

10. Transferimi i punonjësit të Policisë bëhet bazuar në kriteret e përcaktuara, të cilat duhet të jenë në përputhje me gradën, kualifikimet, vlerësimet individuale të punës, kohën e qëndrimit në funksion, si dhe me përshkrimin e pozicionit të punës për atë funksion.

11. Në rast të ndryshimeve strukturore, apo shpalljes së funksioneve të lira për konkurrinim për fitim grade, procesi i transferimit të punonjësve ndërpritet, përveç rasteve të veçanta të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

12. Në rastet e transferimit të punonjësit të Policisë, strukturat e burimeve njerëzore i paraqesin autoritetit përgjegjës dokumentacionin e mëposhtëm:

a) propozimin për transferimin e punonjësit, në të cilin duhet të argumentohet arsyeja e transferimit;

b) vlerësimin e aftësive individuale të punës;

c) mendimin e titullarit të strukturës ku është punonjësi;

ç) kërkesën e punonjësit të Policisë, në rastet kur kërkon vetë të transferohet;

d) ecurinë në karrierë të punonjësit (CV).

13. Transferimi i punonjësit të Policisë me gradë “Drejtues i lartë” si dhe transferimi dhe emërimi në detyrë, i punonjësit në funksione që i korrespondon grada “Drejtues i lartë” bëhet me urdhër të ministrit, pas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

14. Transferimi dhe emërimi në detyrë i punonjësit të Policisë, të atashuar pranë përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë dhe organizatave policore ndërkombëtare, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, bëhet me urdhër të ministrit, pas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

15. Transferimi i punonjësit të Policisë me gradë policore “Nënkomisar” deri në “Drejtues i parë”, si dhe punonjësit të Policisë me gradën “Inspektor”, nga një strukturë vendore në tjetrën, bëhet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, pas propozimit të drejtuesit të strukturës që ka në varësi administrative ose lëndore punonjësën.

16. Kur propozimi për transferim bëhet nga titullarët e strukturave vendore ose titullarët e strukturave të veçanta, dokumentacioni për transferim do të shqyrtohet paraprakisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

17. Transferimi i punonjësit të Policisë me gradë policore “Inspektor” në funksione të së njëjtës gradë, brenda juridiksionit dhe të njëjtit shërbim, bëhet me urdhër të Drejtorit të Policisë vendore ose titullarit të strukturës të veçantë, me propozim të drejtuesit të strukturës që ka në vartësi administrative punonjësën. Kur kalon nga një shërbim në tjetrin punonjësi duhet të jetë i certifikuar për fushën e shërbimit përkatës dhe paraprakisht merret mendimi me shkrim nga Drejtori i Burimeve Njerëzore.”

Rastet e transferimit të punonjësit të Policisë, përcaktohen në nenin 180, të kësaj Rregulloreje, si vijon:

“1. Punonjësi i Policisë mund të transferohet dhe të emërohet në detyrë në çdo strukturë të Policisë së Shtetit, në përputhje me gradën që ka.

2. Transferimi mund të bëhet në rastet e mëposhtme:

a) me kërkesën e punonjësit të Policisë;

b) për nevoja të punës;

c) për fitimin e gradës;

ç) kur shkërtohet funksioni organik në kuadër të pakësimit të limitit të përgjithshëm organik të Policisë;

d) kur ekziston një situatë reale dhe e rrezikshme ndaj jetës dhe familjes së punonjësit të Policisë;

dh) kur punonjësi i Policisë nuk arrin nivelin e nevojshëm të kryerjes së detyrave në funksionin që mban;

e) për ndryshim të statusit të funksionit;

ë) për arsye shëndetësore dhe familjare.”

Neni 193, i Rregullores së Policisë së Shtetit, me titull: “Dosja e personelit në Policinë e Shtetit”¹⁰, parashikon se:

“1. Punonjësit e emëruar në strukturat e Policisë së Shtetit, i krijohet një dosje personeli, e cila administrohet nga strukturat e burimeve njerëzore.

2. Dosja e personelit përmban të dhëna të karakterit teknik, profesional, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë, ecurinë në karrierë etj.

3. Dosja e personelit ka karakter konfidencial. Personat që kanë të drejtë të njihen me dosjen janë:

a) titullari i institucionit, institucioneve të tjera të ngarkuara me ligj;

b) eprori direkt;

c) specialisti i burimeve njerëzore që përgjigjet për mbajtjen dhe administrimin e tyre;

ç) punonjësi që i përket dosja;

d) Komisioneri i Shërbimit Civil;

dh) Departamenti i Administratës Publike (DAP-i).

4. Dosjet e personelit krijohen për:

4.1. Punonjësin e Policisë:

a) Punonjësit të Policisë, me dhënien e gradës dhe emërimit në detyrë, struktura e burimeve njerëzore ku emërohet, i krijon dosje personeli, mbi bazën e dokumentacionit të pranimit.

b) Dosja e personelit të punonjësit të Policisë përmban:

i) Fletë inventarin me listën e dokumentacionit që ndodhet në dosje.

ii) Fleta prezantuese e dosjes, formati i së cilës mund të jetë i ndryshueshëm përmban:

- numrin e identifikimit individual të punonjësit (RMIS);

- emrin, atësinë, mbiemrin;

- numrin kombëtar të identifikimit;

¹⁰ (Shtuar pika 4.1.1 me vendimin nr. 1143, datë 9.12.2020)

- shtetësinë;
- gjininë;
- datëlindja;
- gjendja civile;
- përbërja familjare;
- adresa e vendbanimit të përhershëm;
- adresa e vendbanimit të përkohshëm;
- arsimimi;
- diploma;
- kualifikimi (llojet);
- grada shkencore (titulli);
- njohuri gjuhe të huaj;
- data e fillimit të punës në pozicionin përkatës;
- përshkrimi i karrierës;
- vlerësimet e punës;
- penalitetet (masat disiplinore, gjyqësore);
- njësia e punës;
- pozicioni;
- stimujt dhe shpërblimet.”

VKM nr. 331, datë 22.04.2015 “Për mbrojtjen e veçantë të punonjësit të Policisë që, për shkak të detyrës, i kërcënohet jeta, familja dhe prona”, përcakton se:

1. Policia e Shtetit siguron mbrojtje të veçantë për punonjës të policisë, që, për shkak të detyrës, i kërcënohet jeta, familja dhe prona.
2. Me mbrojtje të veçantë do të kuptohen masat me karakter organizativ dhe profesional për ruajtjen fizike të punonjësit të policisë.
3. Masat e mbrojtjes së veçantë janë:
 - a) ruajtje fizike;
 - b) ruajtje e familjarëve, banesës dhe pronës.
4. Me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit ngrihet Komisioni i Vlerësimit të Kërcënimeve (KVK) për vlerësimin e kërkesave, miratimin e masave të mbrojtjes, ndryshimin, revokimin ose përfundimin e tyre, si dhe struktura përgjegjëse për zbatimin e masave të mbrojtjes së veçantë, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit.
5. Shpenzimet për realizimin e mbrojtjes së veçantë përballen nga buxheti i miratuar për Drejtorinë e Policisë së Shtetit.”

Mbështetur në informacionin, dokumentacionin provues, të depozituar nga palët në proces, si dhe analizimin e akteve ligjore e nënligjore, sa më sipër, Komisioneri vlerëson se:

- Bazuar në pikën 1/b, të nenit 50/1, të ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, parashikohet se, në rolin e parë drejtues përfshihen punonjës të Policisë së Shtetit që mbajnë gradën: “Kryekomisar”, “Komisar” dhe “Nënkomisar”. Në këto kushte, kolegët me të cilët

krahasohet ankuesi, lidhur me transferimin e tyre nga DVP Kukës në drejtori më pranë vendbanimeve të tyre, konsiderohet se janë në kushte të njëjta me të, përsa i përket detyrës që mbajnë, lidhur me rolin e tyre si drejtues të parë, pavarësisht nëse mbajnë gradën “Komisar” apo “Nënkomisar”.

- Kështu, janë përdorur për krahasim me ankuesin situatat e punonjësve të policisë:
- Kryekomisar F. A, banues në Tiranë, transferuar pas rreth 16 muajsh nga emërimi në detyrë, nga DVP Kukës në DVP Shkodër, me gjendje familjare, i martuar me dy fëmijë.
- Kryekomisar B. A, banues në Gjirokastrë, transferuar pas rreth 7 muajsh nga emërimi në detyrë, nga DVP Kukës në DVP Berat, me gjendje familjare, i martuar me një fëmijë.
- Komisar B. Q, banues në Pogradec, transferuar nga DVP Korçë në DVP Kukës, me gjendje familjare, i martuar me dy fëmijë.
- Komisar Xh. K, banues në Laç/Kurbin, transferuar nga DVP Lezhë në DVP Korçë dhe nga DVP Korçë në DVP Kukës, me gjendje familjare, i martuar me dy fëmijë.
- Komisar A. B, banues në Elbasan, transferuar nga DVP Korçë në DVP Dibër, me gjendje familjare, i martuar me një fëmijë.
- Komisar A. M, me vendbanim në Tiranë, pas rreth 6 muajsh nga emërimi, transferuar nga DVP Kukës në DVP Tiranë.
- Nënkomisar A. R, banues në Tiranë, transferuar nga DVP Kukës pranë Akademisë së Sigurisë në Tiranë. (Gjendja familjare i ve, me një fëmijë të mitur)
- Nënkomisare D. A, banuese në Tiranë, transferuar pas rreth 4 muajsh nga DVP Kukës, në DVP Tiranë.
- Nënkomisar D. V, banues në Vlorë, transferuar pas rreth 8 muajsh nga DVP Kukës, në DVP Vlorë, me gjendje familjare, i martuar me dy fëmijë.
- Nënkomisar A. E, banues në Tiranë, transferuar nga DVP Lezhë, në DVKM Kukës, me gjendje familjare, i martuar me një fëmijë.
- Nënkomisar Y. A, banues në Tiranë, transferuar nga DVKM Kukës, në DVKM Korçë.

Nga sa shihet, nisur nga të dhënat e analizuara më sipër, subjekti ankues haptazi është trajtuar në një mënyrë të pabarabartë dhe të pafavorshme, krahasuar me kolegët e tjerë, përsa i përket mundësisë së transferimit të tij, brenda afatit dy vjeçar nga momenti i emërimit në detyrë në DVP Kukës, kjo përsa i takon faktit se:

- Kolegët me të cilët krahasohet ankuesi, në të shumtën e rasteve janë transferuar para ezaurimit të afatit dy vjeçar nga momenti i emërimit të tyre në detyrë (përfshirë kryesisht kolegët të cilët janë transferuar nga DVP Kukës, gjatë periudhës që ankuesi ka ushtruar detyrën e tij pranë kësaj Drejtorie).
- Kolegët me të cilët krahasohet ose janë transferuar në qytetin ku ata dhe familja e tyre banojnë ose në qytete në distancë shumë më të afërt me vendbanimin e tyre, krahasuar me ankuesin, vendbanimi i të cilit është rreth 400 km nga vendi i punës/ DVP Kukës. (referuar google map¹¹, distanca mes Sarandës dhe Kukës rezulton të jetë 393 km).

¹¹ <https://www.distancesfrom.com/al/map-from-Kuks-to-Sarand-Albania/MapHistory/4350891.aspx>

Pra, nisur nga këqyrja e analizimi i secilit rast më sipër, rezulton se subjekti ankues, pavarësisht kërkesave të herëpashershme drejtuar DPPSH-së, lidhur me mundësinë e transferimit të tij në një drejtori vendore, më afër vendbanimit të tij, qoftë edhe duke përgjysmuar distancën nga vendi i punës, është trajtuar në mënyrë të pafavorshme, krahasuar me kolegët e tjerë, të cilët ndonëse kishin dhe më pak kohë të emëruar në detyrë se ankuesi, po pranë DVP Kukës (por jo vetëm, duke vlerësuar edhe shembujt e tjerë të cituar), janë transferuar nga DPPSH ose afër vendbanimit të tyre, ose në vendbanimin e tyre, ose në një distancë jo shumë të madhe nga vendbanimi i tyre (krahasuar me z. I. L).

Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se, nga ana e strukturave përkatëse të DPPSH-së, nuk janë bërë përpjekjet e veprimet e duhura, për të përmbushur kërkesën e ankuesit, nga ana e tyre, lidhur me trajtimin e tij në mënyrë të barabartë me kolegët e tjerë, (lidhur me transferimin e tij në një drejtori më afër vendbanimit të tij), të cilët janë transferuar në detyrë në apo *shumë më afër* vendbanimeve të tyre krahasuar me z. L, edhe pse kishin më pak kohë se ai, të emëruar në detyrë, po pranë të njëjtës drejtori vendore, DVP Kukës.

Në përfundim, bazuar në analizimin e veprimeve të DPPSH-së kundrejt subjektit ankues, Komisioneri vlerëson se, z. I. L është ekspozuar para një trajtimi të pafavorshëm dhe të pabarabartë krahasuar me punonjësit e tjerë të policisë/DVP Kukës, ndodhur në kushte të njëjta me të, përsa i takon mostransferimit të tij në një drejtori vendore, më afër vendbanimit të tij, qoftë edhe duke përgjysmuar distancën nga vendi i punës.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2¹², të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

¹²“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, të LMD, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ky ligj ka bërë në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit, garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura.

B.1 Bindjet politike, gjendja familjare dhe vendbanimi

Në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se shkakun i pretenduar prej saj është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak.

Ankuesi ka pretenduar diskriminim për shkaqet sipërcituar, duke pretenduar se është trajtuar në mënyrë të diferencuar dhe të pafavorshme nga ana e DPPSH-së, krahasuar me kolegët e tjerë, përsa i përket kërkesës për transferimin e tij në një drejtori më afër vendbanimit, për shkak të bindjeve politike të familjarëve të tij, gjendjes familjare (me të cilën ankuesi elaboron faktin se ka dy fëmijë të mitur dhe prindër të moshuar për të cilët duhet të kujdeset), si dhe për shkak ai është i vetmi punonjës që është transferuar në një vend pune në distancë kaq të madhe nga vendbanimi, në rreth 400 km distancë.

Në këtë kontekst, Komisioneri për të vlerësuar nëse pretendimet e ankuesit për trajtim të pabarabartë e të pafavorshëm të DPPSH-së, vijnë për shkaqet e pretenduara, duhet që fillimisht këto shkaqe të jenë provuar e dokumentuar para KMD-së, si shkaqe të njohura nga LMD.

Bazuar në shpjegimet e dokumentacionin e depozituar nga subjekti ankues gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje, evidentohet se:

- Në lidhje me shpjegimin e arsyeshëm e provueshmërinë e pretendimit se trajtimi i pabarabartë e i pafavorshëm ka ardhur për shkak të *“bindjeve politike” të familjarëve të tij*, ankuesi parashtron se:

“Mendoj se shkakun kryesor është politik. Kjo për shkak të lidhjeve të familjarëve të mi me Partinë Demokratike. Familjarët e mi kanë qenë dhe janë pjesë e PD-së. Prej vitesh, sa herë që ka procese zgjedhore familjarët e mi kanë qenë dhe janë të angazhuar me PD-në. Vëllezërit e mi gjatë të gjitha fushatave kanë qenë aktiv në fushatat në krah të Kryetarit të PD-së, z. L. B, në fushatat zgjedhore në Fier dhe Mallakastër.

Prindërit kanë patur lokal në Fratar, Mallakastër dhe të gjitha takimet elektorale të PD-së në Fratar, gjatë fushatave zgjedhore janë bërë në ambientet e lokalit të prindërve të mi, që nga viti 1992 e në vazhdim.

Ju vë në dispozicion dokumentet e anëtarësisë në PD, të babait tim Sh. L dhe të njërit prej vëllezërve të mi. Fakti që familja ime është e djathtë është fakt i njohur botërisht.

Pavarësisht bindjeve të brendshme dhe pengesës ligjore, unë kam qenë dhe jam i depolitizuar, personalisht nuk dua t'ia di për aspektin politik, pasi jam punonjës policie dhe i shërbej atdheut.

...mbase të gjitha këto mund edhe të jenë për këtë shkak, pra, për arsye politike nga punonjës të indoktrinuar politikisht, megjithëse në bindjen time sot, në Policinë e Shtetit nuk ka drejtues të indoktrinuar politikisht.”

Referuar dokumentacionit lidhur me provueshmërinë e bindjeve dhe aktivitetit politik të familjarëve të tij, ankuesi ka depozituar në cilësi prove kartat e anëtarësisë së tyre, ku evidentohen të dhënat respektive :

- I ati i ankuesit, z. Sh. L, mban Kartën e Anëtarësisë në PD, me nr. 061506, Seksioni Damës 2. Data e lëshimit të Kartës është 12.01.2002;
- Z. M. Sh. L, vëllai i ankuesit, mban Kartën e Anëtarësisë në PD, me nr. 135995, Dega Fier/Seksioni nr. 8. Data e lëshimit të Kartës është 12.03.1991.

Bazuar në të dhënat e cituara në dokumentacionin e mësipërm, rezulton se kartat e anëtarësisë së familjarëve të z. L, (babait dhe vëllait të tij), i përkasin një periudhë shumë të hershme, respektivisht rreth 33 dhe 22 vite më parë. Ankuesi pretendimet për diskriminim për shkaqe politike, i ka ngritur lidhur me faktin e mos transferimit të tij, moment që lidhet pazgjidhshmërisht me periudhën e kërkesës së tij të parë për transferim, pra, me vitin 2022.

Në këtë kontekst, do të duhej që të gjitha faktet e provat që provojnë bindjet e aktivitetin politik të familjarëve të tij, të datonin minimalisht në 3 vitet e fundit. Koha e gjatë e lëshimit të kartave të anëtarësisë së babait dhe vëllait të ankuesit në PD, i bën të pavlefshme ato në cilësi prove lidhur me dokumentimin e bindjeve të tyre politike, pasi përgjatë këtyre viteve janë lëshuar apo rinovuar dokumente të reja anëtarësie. Po ashtu, aderimi i tyre në PD, përpara me shumë se 20 vitesh, pa prova, fakte e dokumentacion të rifreskuar, nuk i bën ata automatikisht që dhe aktualisht të jenë anëtarë, përkrahës e aktivistë të po kësaj force politike.

Komisioneri vëren gjithashtu se, qëndrimi i ankuesit lidhur me pretendimin e tij për diskriminim për shkak të bindjeve politike nga ana e DPPSH-së, është disi kontradiktor, pasi po vetë ankuesi pohon se, në bindjen e tij sot, në Policinë e Shtetit nuk ka drejtues të indoktrinuar politikisht.

Komisioneri thekson faktin se, ankuesi ka qenë pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit prej një kohe relativisht të gjatë, dhe nuk evidentohet që bindjet politike të të afërme të tij të kenë ndikuar në ndonjë situatë negative kundrejt tij.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankuesit për diskriminim për shkak të “*bindjeve politike të familjarëve të tij*” nuk rezulton i provuar bazuar në provat e depozituara prej tij.

- Në lidhje me shpjegimin e arsyeshëm e provueshmërinë e pretendimit se trajtimi i pabarabartë e i pafavorshëm ka ardhur për shkak të “*gjendjes familjare*” ankuesi parashtron se:

“Diskriminimi im për shkak të gjendjes familjare vjen pasi unë jam baba i dy fëmijëve të mitur, përkatësisht 4 dhe 8 vjeçar, si dhe detyrime të tjera ndaj dy prindërve të mi, përkatësisht 75 dhe 85 vjeçar.

Përsa i përket prindërve, prej vitesh janë banorë në Sarandë, nuk janë me mua në certifikatë familjare, pasi bëjnë një jetë të ndërthurur midis Sarandës dhe Mallakastrës. Gjatë muajve që prindërit janë në Sarandë, për çdo gjë që kanë nevojë janë detyrime të miat, por pa diskutim që edhe vëllezërit e mi të cilët jetojnë në qytetin e Fierit, kanë detyrimet e tyre ndaj prindërve.”

- Sa i takon detyrimeve të ankuesit kundrejt prindërve të moshuar:

Referuar Certifikatës Familjare, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile nr. 433, Njësia Administrative Sarandë, me datë 09.02.2024, si dhe gjeneraliteteve të ankuesit, rezulton se:

- Sh. L, (i ati i ankuesit) është i datëlindjes 06.09.1939 (kryefamiljar)

- H. L, (nëna e ankuesit) është e datëlindjes 20.01.1949 (bashkëshorte).

Evidentohet se prindërit e ankuesit, në momentin e transferimit të tij në DVP Kukës, kanë patur moshat respektive 83 dhe 75 vjeç. Bazuar në të dhënat e mësipërme, prindërit e ankuesit nuk figurojnë në certifikatën familjare me të, por janë më vete, fakt të cilin e pohon dhe vetë. Ankuesi nuk ka depozituar një akt tjetër shkresor a dokumentues për të provuar që ai është personi i vetëm që kujdeset për ta, por, përveç sa më sipër, pohon që prindërit vetëm në periudha të caktuara kohore gjatë vitit jetojnë në Sarandë, dhe pjesën tjetër të vitit në Mallakastër.

Komisioneri vëren se, shpjegimi i dhënë nga ankuesi se, distanca e madhe ka ndikuar në faktin që ai nuk mund të përkujdeset siç duhet për prindërit e moshuar, gjatë periudhës kur ata jetojnë në Sarandë, nuk shërben si e dhënë apo provë dokumentuese e shkakut të pretenduar “gjendjes familjare”, në kontekst të LMD-së, pasi ai nuk ka dokumentuar e provuar në mënyrë bindëse se, detyrimin për përkujdesjen apo përgjegjësitë kundrejt tyre i ka vetëm ai, përsa kohë ata as nuk janë në përbërjen familjare të ankuesit (familja e tij përbëhet nga ai, bashkëshortja dhe dy fëmijët), dhe për sa kohë ai nuk provon se prindërit e tij “varen” nga ankuesi apo kanë nevojë për praninë e tij përsa i takon nevojës për kujdes a përkujdesje të çfarëdolloji. Ankuesi po ashtu pohon se për prindërit kujdesen si ai, ashtu dhe vëllezërit e tij. (Fakt për të cilin, Komisioneri thekson se, çdo fëmijë e ka detyrim qoftë moral, qoftë ligjor përkujdesjen kundrejt prindërve, aq më tepër kur ata janë në një moshë të tillë)

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankuesit për diskriminim për shkak të “gjendjes familjare”, në kuptim të LMD-së, duke nënkuptuar nevojën për përkujdesje kundrejt prindërve të moshuar, nuk rezulton i provuar dhe dokumentuar bazuar në provat e depozituara prej tij.

- Sa i takon detyrimeve të ankuesit kundrejt fëmijëve të mitur:

Gjendja familjare¹³ ose martesore ka të bëjë me marrëdhëniet martesore, farefisnore ose prindërore të cilat një person ka me persona tjerë. Gjendja familjare ose martesore mund të ndryshojë

¹³ <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

ndërmjet individëve, pasi ata mund të jenë të martuar ose jo, në një marrëdhënie de facto ose në një marrëdhënie që nuk e njeh ligji, të divorcuar ose të ve, jetojnë në një familje të zgjeruar ose kanë përgjegjësi të ndryshme për fëmijët dhe personat e varur ose një numër të caktuar fëmijësh.

Referuar Certifikatës Familjare, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile nr. 433, Njësia Administrative Sarandë, me datë 12.02.2024, rezulton se:

- I. L, (ankuesi) është i datëlindjes 15.12.1977 (kryefamiljar)
- E. L, (bashkëshortja e ankuesit) është e datëlindjes 26.03.1987.
- N. L, (e bija) është e datëlindjes 11.01.2016.
- B. L, (i biri) është i datëlindjes 02.11.2019.

Komisioneri vëren se, fakti i mohimit të përkujdesjes kundrejt fëmijëve të mitur, për shkak të distancës së madhe të vendit të punës nga vendbanimi i familjes, pretenduar nga ankuesi, gjen mbrojtje ligjore nën ombrellën e shkakut të LMD-së, cilësuar si “përgjegjësi prindëror”, i cili edhe në kuptim të nenit 215 e vijues të Kodit të Familjes, nënkupton përkujdesjen e prindërve kundrejt fëmijëve.

Neni 215, i Kodit të Familjes, përcakton se: *“Përgjegjësia prindërore përfshin tërësinë e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij.”*

Edhe në kuptim të LMD-së, përgjegjësia prindërore, lidhet me tërësinë e të drejtave dhe detyrave që kanë prindërit me qëllim që të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin...¹⁴.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankuesit për diskriminim, lidhur me faktin se distanca e madhe e vendbanimit me vendin e punës, pengon atë në ushtrimin e të drejtës prindërore dhe përkujdesjes si baba kundrejt dy fëmijëve të mitur, në kuptim të LMD-së, rezulton i provuar dhe dokumentuar bazuar në provat e depozituara prej tij, duke e cilësuar tek shkakun i “përgjegjësisë prindërore”.

- Në lidhje me shpjegimin e arsyeshem e provueshemerine e pretendimit se trajtimi i pabarabartë e i pafavorshëm ka ardhur për shkak të “vendbanimit”.

Gjatë shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues ka pretenduar diskriminim për shkak të “vendbanimit”, duke argumentuar se në dijeninë e tij ai është i vetmi punonjës policie, i cili është emëruar në detyrë në një vend pune në distancë ekstreme nga vendbanimi, mbi 400 km, dhe se, pavarësisht se kishte mundësi për sistemimin e tij në një drejtori më afër vendbanimit, qoftë edhe

¹⁴ <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

në përgjysmim distance, kërkesat e tij nuk janë marrë parasysh, duke e detyruar të japë dorëheqjen e detyruar.

Vendbanimi presupozon se ushtrimi i të drejtave nuk mund të kushtëzohet ose të varet nga vendbanimi i tanishëm ose i mëparshëm i një individ. Kështu, një individ nuk mund të diskriminohet për shkak se jeton ose është regjistruar në një zonë urbane ose rurale, në një vendbanim formal ose jo, apo nëse ka një stil jetese si nomad apo sedentar. Diferencat ndërmjet rajoneve duhet të eliminohen në praktikë duke siguruar një dyscheme standardesh të një shpërndarje të barabartë për të gjitha shërbimet publike¹⁵.

Referuar akteve të depozituara rezulton se, ankuesi është banor i qytetit të Sarandës. Deri me datë 16.02.2022, z. L mbante detyrën si Specialist për Hetimin e Krimeve në Komisaratin e Policisë Sarandë, ndërsa me datë 17.02.2022, është emëruar në detyrë në DVP Kukës. Referuar google map¹⁶, distanca mes Sarandës dhe Kukës rezulton të jetë 393 km.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankuesit për diskriminim për shkak të “vendbanimit”, në kuptim të LMD-së, duke evidentuar se distanca e madhe e pengon në ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, për shkak se ka dy fëmijë të mitur dhe prindërit e moshuar, nuk qëndron, pasi kjo pengesë vjen si pasojë e kësaj distance (të vendit të punës/DVP Kukës, me vendbanimin e tij/Sarandë), por nuk është shkak në vetvete, për të cilin atij i është bërë diferenca në trajtim krahasuar me kolegët e tjerë të cilët u transferuan në apo më afër vendbanimeve të tyre. Ankuesi nuk arriti të provojë se si “vendbanimi” i tij, ka ndikuar tek DPPSH-ja, në mostransferimin e ankuesit nga DVP Kukës.

Në këtë kuptim, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankuesit për diskriminim bazuar në shkakun e *vendbanimit*, nuk është i bazuar në kuptim të LMD-së dhe nuk mund të pranohet.

C. Lidhja e trajtimit të pabarabartë dhe të pafavorshëm të ankuesit nga DPPSH, me “përgjegjësinë prindërore” si shkak i mbrojtur.

Për të vërtetuar faktin se subjekti ankues është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e DPPSH-së, duhet të ekzistojë një lidhje objektive shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, dhe trajtimit të pabarabartë e të pafavorshëm të ankuesit, krahasuar me kolegët e tjerë të tij.

Ankuesi ka pretenduar diskriminim për shkak të “*gjendjes familjare*”, duke argumentuar se trajtimin e pabarabartë e të pafavorshëm ndaj tij, nga ana e DPPSH-së, e lidh me faktin se distanca e madhe e vendbanimit me vendin e punës, e pengon atë në ushtrimin e të drejtës prindërore dhe përkujdesjes si baba kundrejt dy fëmijëve të mitur.

¹⁵ <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

¹⁶ <https://www.distancesfrom.com/al/map-from-Kuks-to-Sarand-Albania/MapHistory/4350891.aspx>

Sa më sipër, Komisioneri, në analizën e bërë prej tij¹⁷ vlerëson se, shkak i pretenduar i ankuesit, në kuptim të LMD-së, rezulton i provuar dhe dokumentuar bazuar në provat e depozituara prej tij, duke e cilësuar tek shkak i “përgjegjësisë prindërore”. Bazuar në dokumentacionin që disponon nga hetimi, Komisioneri vlerëson se ankuesi e mbart këtë shkak.

Komisioneri ka shqyrtuar dhe analizuar faktin, nëse subjekti ankues, është trajtuar në mënyrë të pabarabartë e të pafavorshme nga ana e DPPSH-së, krahasuar me kolegët e tjerë në kushte të njëjta a të ngjashme me të, bazuar pikërisht në shkakun që posedon, atë të përgjegjësisë prindërore.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive për trajtimin ndryshe të evidentuar.

Lidhur me sa më lart, Komisioneri ka vlerësuar se ankuesi është ekspozuar para një trajtimi të pabarabartë e të pafavorshëm, nga ana e DPPSH-së, krahasuar me punonjësit e policisë sipërcituar në vendim, në kushte të njëjta a të ngjashme me të, përsa i takon mosshqyrtimit efektiv të kërkesave dhe ankimit të tij, lidhur me transferimin në një vend pune (drejtori) më afër vendbanimit të tij, si dhe mos përmbushjes së kësaj kërkesë.

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar, si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Neni 18, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku sanksionohet ky parim parashikon : *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.”*

Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*.

Doktrina kushtetuese, e trajton të drejtën e individit për punë, duke theksuar se liria për punë mbrohet nga rregullimet kushtetuese.¹⁸

Gjykata Kushtetuese¹⁹, ka mbajtur qëndrimin se: *“E drejta për punë, që garanton neni 49/1 i Kushtetutës, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit profesional me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetuese, përbën një të drejtë të individit në kuptimin, që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës.*

¹⁷ Shih faqe 26 e vendimit.

¹⁸ Livio Paladini, “Diritto Costituzionale”, CEDAM, Padova, 1991, fq. 166-175.

¹⁹ Vendimi nr. 20, datë 11.07.2006, i GJK.

Kjo e drejtë e individit për të përfutuar me punë të ligjshme fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi.

E drejta për punë dhe liria e profesionit nënkuptojnë të drejtën e individit për të ushtruar çdo veprimtari të ligjshme që i sjell të ardhura dhe që nuk ka afat të përcaktuar, me përjashtim të rregullimeve të veçanta ligjore. Në këtë kuptim, veprimi i organeve shtetërore që sjell pasoja të drejtpërdrejta në pengimin e veprimtarisë profesionale përbën cenim të kësaj lirie veprimi. Garancia që Kushtetuta i jep individit lidhur me të drejtën për punë dhe lirinë e profesionit ka si qëllim mbrojtjen e këtyre nga kufizimet e papërligjura të shtetit.

Liria e profesionit nuk është thjesht një e drejtë për të pasur një vend pune. Ajo nuk duhet kuptuar vetëm si e drejtë sociale, por dhe si liri negative që nuk lejon ndërhyrjen ose pengimin e shtetit gjatë ushtrimit të saj. Përcaktimi që neni 49 i Kushtetutës i bën të drejtës për punë duhet të merret në kuptim të dyfishtë. Ajo përbën një detyrim pozitiv që kërkon angazhimin shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e një të drejte të tillë, por edhe detyrim negativ, i cili kërkon mosndërhyrjen e shtetit për të cenuar këtë të drejtë”.

Në rastin në fjalë kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune midis shtetit dhe individit, e cila rregullohet nga kuadri ligjor në fuqi.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor²⁰.

Me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e drejta ndërkombëtare që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare (*e njohur ndryshe edhe si “e drejta konventore”*) ka një vend të posaçëm.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Po ashtu, kjo dispozitë kushtetuese duhet lexuar në harmoni edhe me nenin 122, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, ku sanksionohet se:

“1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji...

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të...

²⁰ Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011, nr. 23, datë 08.06.2011.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), në nenin 14 të saj, ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë joshteruese shkaqesh. Ndërkohë Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur subjekti është diskriminuar:

“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;

b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;

c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;

d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejte parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

“Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore²¹”, i cili sanksionon të drejtën për punë në nenin 6, të tij. Sipas këtij akti ndërkombëtar në fushën e të drejtave të njeriut, i cili është ratifikuar nga vendi ynë, parashikohet se, e drejta për punë përfshin të drejtën e secilit për të pasur mundësinë e sigurimit të jetesës, duke punuar e pranuar lirisht dhe marrjen e masave të përshtatshme për ta mbrojtur këtë të drejtë. Sipas nenit 2/2, të Paktit, të drejtat e parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim.

Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO)²² *“Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”*, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion barazie i specializuar për mbrojtjen nga diskriminimi, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ka si qëllim të sigurojë të drejtën e çdo personi për: *“a) barazi*

²¹ Ratifikuar me ligjin nr. 7511, datë 08.08.1991

²² Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.”

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës.

Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekti i një rregullimi të posaçëm.

I njëjti rregullim në lidhje me barrën e provës parashikohet edhe në nenin 82, pika 2 e Kodit të Procedurës Administrative, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin 33, pika 7/1 të ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se : *“7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”*

Kodi i Procedurës Administrative dhe ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, kanë saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast DPPSH-së, i cili duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të pafavorshme, për shkakun e pretenduar prej tij.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Pasi personi që pretendon diskriminim krijon një prezumim të diskriminimit (*diskriminimi prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

- Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.

- Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Sa i takon rastit në fjalë, KMD, bazuar në shqyrtimin e fakteve dhe provave të depozituara, arrin në përfundimin që subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të pabarabartë e të pafavorshëm nga ana e DPPSH-së, krahasuar me kolegët e tij, përse i takon mostransferimit të tij në një drejtori, vend pune më afër vendbanimit të tij. Njëkohësisht, sa më sipër, rezultoi e provuar dhe përgjegjësia prindërore e ankuesit.

Por, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht konstatimit të këtij fakti, ankuesi nuk arriti të provojë se shkakun e pretenduar prej tij, ka shërbyer si shkak për të cilin ai është diskriminuar nga ana e DPPSH-së.

Lidhur me shkakun e pretenduar nga ankuesi, Komisioneri vlerëson se në pamje të parë “përgjegjësia prindërore” është shkak i mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, por referuar rrethanave, kontekstit të zhvillimit të ngjarjeve, fakteve dhe provave të sjella nga palët, subjekti ankues nuk arriti të argumentojë se përgjegjësia prindërore e tij, ka ndikuar në mostransferimin e tij dhe të jetë bërë shkak për diskriminimin nga DPPSH.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

- Shumica e punonjësve të policisë, me të cilët ankuesi është krahasuar përse i përket mosmiratimit të kërkesës së tij për transferim nga DVP Kukës në një drejtori më afër vendbanimit të tij, Sarandës, kanë në përbërjen e tyre familjare, fëmijë të mitur (për ilustrim: F. A, dhe D. V rezultojnë me gjendje familjare të martuar dhe me dy fëmijë; A. M po ashtu me një fëmijë dhe i ve).
- Po ashtu, moshë mesatare e punonjësve të policisë (përfshirë edhe ankuesin) rezulton të jetë relativisht e re. Pra, në këtë këndvështrim, edhe përbërja (gjendja) e tyre familjare mund apo është krahasimisht e përafërt, edhe përse i takon moshës së fëmijëve që ata kanë. Disa mund t'i kenë në moshë minorene, disa adoleshentë, që po ashtu kanë nevojë për përkujdesje të shtuar prindërore, etj. Pra, nisur vetëm nga kjo gjendje faktike e situatës familjare të ankuesit, qoftë edhe duke u krahasuar me punonjësit e tjerë të policisë në kushte të njëjta a të ngjashme me të, përse i takon transferimeve të tyre, nuk mund të dilet në konkluzionin se ka shërbyer si shkak për refuzimin e transferimit të tij.

Sa më sipër, bazuar në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, pavarësisht konstatimit të trajtimit të pabarabartë dhe të disfavorshëm ndaj ankuesit nga ana e DPPSH-së, lidhur me mosmiratimin e kërkesës së tij për transferim në një drejtori më afër vendbanimit dhe ekzistencës së shkakut të mbrojtur të diskriminimit, faktet dhe provat e administruara janë të pamjaftueshme për të krijuar prezumimin se kjo sjellje të cilës i është nënshtruar ankuesi, është për shkak të përgjegjësive prindërore.

Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur bazuar në faktet dhe provat e administruara nuk mund të prezumohet se diskriminimi ka ndodhur, DPPSH, nuk mund të ngarkohet me detyrimin për të

provuar se trajtimi i pabarabartë dhe më pak i favorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesi, përbën diskriminim.

Konstatimi i trajtimit të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe ekzistenca e shkakut të pretenduar të diskriminimit, nuk mund të çojnë *apriori* në përfundimin se jemi përpara një sjellje diskriminuese, për sa kohë që nuk mund të prezumohet lidhja shkakësore, pra se shpjegimi i vetëm i arsyeshëm për mostransferimin e ankuesit nga DVP Kukës, ka qenë se ai ka dy fëmijë të mitur.

Sjellja diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo paligjshmëri përbën diskriminim, pasi për t'u konsideruar i tillë duhet të lidhet domosdoshmërisht me një shkak të mbrojtur të LMD-së.

Në bazë të provave të administruara Komisioneri vlerëson se, nuk rezulton të ketë një lidhje shkakësore midis trajtimit të pabarabartë a të pafavorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesi dhe shkakut të pretenduar në këtë rast, që është përgjegjësia prindërore e tij. Për rrjedhojë, në këtë rast nuk mund të konkludohet për sjellje apo veprime diskriminuese karshi tij.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk rezulton që DPPSH, të ketë shkelur dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

- Lidhur me mostrajtimin e ankesës së z. L dhe arsyeve të parashtruara prej tij, lidhur me pretendimin për diskriminim, nga ana e DPPSH-së

Me datë 20.06.2023, ankuesi i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke paraqitur ankimin e tij, ku ndër të tjera parashtron se:

“Prej muajit shkurt 2022 jam emëruar e transferuar në detyrën e Shefit të Sektorit për Shërbimet Policore të Specializuara në DVP Kukës. Nëpërmjet kërkesave të herëpashershme, për arsye familjare të krijuara nga largësia prej më shumë se 400 km nga vendbanimi i familjes time, Sarandë, gjendja e vështirë e krijuar në familjen time, kam kërkuar të transferohem në detyrë në një nga DVP apo DVKM, më pranë vendbanimit, sipas nevojave dhe hapësirave të DPPSH-së. Gjithashtu, edhe meraku se gjatë karrierës për shkak të detyrës kemi lënë mbrapa armiqësi, duke ju përmendur njërin rast, ku në muajin shtator 2008, anëtarë të grupeve kriminale vendosën eksploziv dhe hodhën në erë automjetin tim, të dyshuar të grupit kriminal B.13, pasi disa prej tyre i kisha arrestuar dhe patur nën hetim. Por edhe të faktit se në atë periudhë kisha nën hetim dhe ndiqja, në bashkëpunim me specialistët e DPPSH-së, dosjen e një vrasjeje në kufirin me Greqinë, në Konispol, ku nga grupet e trafikut ndërkombëtar të drogës, u vra një shtetas, të cilit iu pre koka dhe iu gjend vetëm trupi.

Në kthim përgjigjet e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore/DPPSH-së, nuk është marrë parasysh kërkesa ime, me pretendimin se nuk kam mbushur afatin e qëndrimit 2 vjeçar në detyrë, ndërkohë që, vetëm në DVP Kukës janë bërë disa lëvizje të personelit në rang shefa sektorësh dhe seksionesh, të cilët madje janë emëruar pas emërimit tim në detyrë në DVP Kukës. Ata kanë qëndruar në detyrë vetëm 5 apo 6 muaj, dhe janë transferuar dhe sistemuar në sektorë dhe komisariate më pranë familjeve të tyre. Megjithëse rasti im, është i vetmi në strukturën e DPPSH-së, 400 km larg familjes, nuk është marrë fare në konsideratë gjendja dhe arsyet e mija familjare.

Po diskriminohem krahasimisht me kolegët e mi në DVP Kukës të cilët në ndryshim nga unë janë transferuar në mënyrë selektive dhe pa ndjekur asnjë lloj rregulli apo planifikimi. Nuk i paragjykoj

kolegët e transferuar në detyra dhe rrethe pranë familjeve të tyre, por për shkak të zbatimit me drejtësi dhe korrektësi të politikës së kuadrit, fillimisht duhet të isha unë punonjësi, për të cilin duhet të jepej një zgjidhje e problemit të sistemimit në një vend punë, qoftë e dhe duke përgjysmuar largësinë nga vendbanimi i familjes time, por edhe nisur nga fakti se unë kisha më shumë kohë në detyrë në DVP Kukës se kolegët e tjerë që u transferuan.

Përsërita kërkesën time për transferim, në kuadër të ristrukturimit të Policisë së Shtetit, me qëllimin që tani ishin krijuar më shumë vende vakante dhe më shumë mundësi për sistemimin tim në një vend më afër vendbanimit të familjes time. Në strukturën e re, në drejtoritë vendore më afër vendbanimit tim, psh. DVP Gjirokastrë apo Vlorë, në sektorë apo komisariate të tjera, kishte vende të cilat përkojnë me gradën Kryekomisar, apo dhe në DVKM.

Nuk kam kërkuar vend pune ku të privilegjohem, por kërkoj një të drejtë ligjore, të më zvogëlohet distanca nga familja dhe fëmijët e mi, për arsye familjare.

...mosmarrja parasysh e asnjë prej kërkesave të mia, po më çon në demoralizim, ka sjellë pasoja psikologjike tek unë dhe familja, duke hedhur poshtë dhe diskriminuar mua si punonjës policie me mbi 23 vite karrierë, por edhe familjen time.

...pas kaq shumë vitesh i lidhur me profesionin tim dhe sakrificave të shumta në Policinë e Shtetit, nuk e meritoj këtë diskriminim dhe mungesë vlerësimi, fakte që po më detyrojnë të mos më ngelet asnjë hapësirë tjetër veçse të largohem nga strukturat e Policisë së Shtetit dhe të ndërpres karrierën time.

Po ju drejtohem ju, si prind i dy fëmijëve të mitur, pasi largësia e punës time nga familja është jashtëzakonisht e madhe, nga njëri skaj i Shqipërisë në tjetrin, 400 km larg. Duke qenë se gjatë ushtrimit të detyrës siç dhe jua shpjegova, jam përplasur me kontigjentin kriminal, për shkak të kryerjes së detyrave hetimore dhe arrestimeve të tyre, duke më hedhur makinën në erë në vitin 2008, nuk mund të qëndroj apo të fle dot i qetë në Kukës, kur familja ime dhe dy fëmijët e mitur janë 400 km larg. Po ashtu edhe arsyet e tjera familjare sa më sipër shpjegova, më bëjnë të pamundur të përmbush detyrimet e mija familjare si prind, kur ata kanë nevojë për mua si baba.

Ju lutem të merrni masa për ankesën time, gjendjen e rënduar shpirtërore, morale, stresuese për mua dhe familjen time, krijuar nga distanca shumë e largët, vendosni autoritetin tuaj mbi diskriminimin dhe moszbatimin me përpikëri të ligjit, për trajtimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, për të më transferuar në një vend punë më pranë familjes.

Veprimet jo të drejta dhe qëndrimi diskriminues i mbajtur ndaj meje, po më detyron mua si oficer karriere në Policinë e Shtetit t'i drejtohem dhe të kërkoj mbështetje për zgjidhjen e kërkesës time, Ministrit të Brendshëm dhe Kryeministrin të Shqipërisë."

Në ankesën e tij drejtuar DPPSH-së, ankuesi ka ngritur haptazi pretendimin se ai po diskriminohet duke u trajtuar në mënyrë të pabarabartë me kolegët e tij, të cilët janë transferuar në drejtori në apo shumë më afër vendbanimit të tyre, krahasuar me të, që ishte 400 km në distancë nga vendbanimi i familjes, duke parashtruar edhe shkaqet e arsyet e tij.

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 13, pika 1, shkronja c)²³, e tij ka parashikuar se: *“Punëdhënësi është i detyruar:.....t’u përgjigjet efektivisht dhe në përputhje me këtë ligj ankimeve të marra për shkak të diskriminimit të kryer nga punëmarrësit e tij, brenda një muaji nga marrja e tyre”*.

Neni 15²⁴, i LMD-së, ka parashikuar se: *“Çdo punëmarrës ka të drejtë të ankohet te punëdhënësi, te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ose në gjykatë, nëse beson se ka pësuar diskriminim. Kjo dispozitë nuk e kufizon të drejtën e ankimit në institucione të veçanta, të ngritura pranë sektorëve të ndryshëm të punësimit*.

Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës, punëmarrësi ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve të kontratës.

Punëmarrësi ka të drejtë të marrë informacion në çdo kohë në lidhje me trajtimin e ankesës, si dhe të marrë shpjegime për vendimet e marra nga punëdhënësi, në përgjigje të ankesës së tij, menjëherë pas shqyrtimit.

Në rast se punëdhënësi nuk merr masa për të hetuar dhe për të zgjidhur ankesën për diskriminim, punëmarrësi që ka bërë ankesën ka të drejtë ta ndërpresë punën, pa humbur të drejtën e pagës, për aq kohë sa është e nevojshme për t’u mbrojtur nga diskriminimi. Punëmarrësi kthen pagën e marrë, sipas këtij neni, në rast se diskriminimi i pretenduar nuk rezulton i vërtetuar me vendim të formës së prerë”.

Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri gjykon se, DPPSH, nuk ka zbatuar parashikimet ligjore të LMD-së lidhur me hetimin dhe shqyrtimin *efektiv* të ankesës për diskriminim të ankueses dhe haptazi i ka shkelur ato. Komisioneri vëren se, DPPSH nuk i është përgjigjur dhe as ka shqyrtuar pretendimin e ankuesit për diskriminim.

Në rast se do të kishte ndjekur një procedurë të tillë ligjore të parashikuar shprehimisht në LMD, DPPSH, duhet të kishte patur në konsideratë njëherësh edhe zbatimin e parimit të kontradiktoritetit, si një garanci që ankuesit duhet t’i ishin krijuar mundësitë që ankesa e tij me pretendim diskriminimin, të trajtohej efektivisht dhe ai të dëgjohej dhe të paraqiste argumentet e provat e tij.

Shkelja e këtij parimi përbën shkelje të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, qëndrim ky i konsoliduar tashmë në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ. Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 69, dt. 16.10.2000 të saj, ka mbajtur qëndrimin se: *“Parimi i kontradiktoritetit lidhet e me të drejtën e palëve për t’u dëgjuar, për t’i bërë të njohur njëra tjetrës mjetet dhe faktet mbi të cilat i mbështesin të gjitha pretendimet e tyre, provat e grumbulluara, referencën e saktë ligjore”*.

Në këtë kontekst, DPPSH, duhet të kishte marrë masa konkrete dhe efektive për trajtimin e pretendimeve të ankuesit, sipas parashikimeve ligjore.

²³ Detyrimet e punëdhënësit.

²⁴ Të drejtat e punëmarrësit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, I. L, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për shkaqet e pretenduara prej tij.
2. DPPSH, rekomandohet të marrë masa për parashikimin në aktet përkatëse të saj, të procedurës për shqyrtimin efektiv të ankesave me pretendim diskriminimin, sipas përcaktimeve të nenit 15, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA